



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	05/2021
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	08. 10. 2021 ora 10:00

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive "KKS" – Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS).

Në takim morën pjesë :

Bali Muharremaj-Kryetari i Komunës

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë

Xhevahir Hasanaj - përfaqësues i FSK-së

Halim Shehu - Komuniteti Islam

Mikel Sopi - Komuniteti katolik

Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë

Astrit Bytyqi - Përfaqësues i OJQ-së

Adem Dergut i- Kryetr i KPAK-së

Astrit Vrella – mediat lokale

Fetije Bytyqi - Përfaqësuese e KLSP-së.

Remzi Bajselmani - Drejtor i Arsimit

Habibe Bytyqi i - Zyrtare për barazi gjinore

Xheladin Sadikaj - Përfaqësues i zyrës KKK-së

Hanife Bytyqi - Përfaqësuese e KPAK-së

Zekë Berisha - Përfaqësues i KRE-ja

Shkëndije Shabanaj - Kryesues i KK-së dhe përfaqësuesi KA-li

Shaqir Palush i -Komuniteti i biznesit

Nazim Shabanaj - Përfaqësuese e Egjiptasve

Në takim munguan:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Siguria në trafik;
3. Raportimi dhe masat për parandalimin e dhunës në familje ;
4. Informatë nga drejtoria e shërbimeve publike,mjedis dhe emergjencë lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin veror dhe përgatitja për sezonin e dimrit;

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nënkyetarja e Komunës znj.Mihrije Suka.

Nënkyetarja - përshëndet të pranishmit. I njofton të pranishmit me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkyetarja - e hedh në votim

Aprovohet

Pika 2. Siguria në trafik;

Nënkyetarja - e elaboron këtë pikë dhe ia jep fjalën komandantit të policisë.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Kemi situatë të qetë dhe stabile. Nuk ka mugu angazhimi i policisë. Kemi pas plane enkas për sigurinë në trafik. Këtë vit kemi pas më shumë aksidente se vitin e kaluar. Kemi një vdekje në fshatin Peqan. Në vitin 2020 nuk kemi pas asnjë rast,aksidente dhe lëndime 143 raste,aksidente me dëme materiale 172 raste, persona të lënduar 256 raste.Sa i përket parandalimit të aksidenteve kemi shqiptu 6708 tiketa. Ajo që mungon,është ndriçimi i zonave të vendkalimeve për këmbësor,pastaj sinjalizimi në disa pika p.sh.Biraqi,Qafa e Duhlës etj. Ne do ti rrisim shërbimet tona. Kundërvajtësit,sidomos ata pa patentë do të ndëshkohen.

Mikel Sopi - në fshatin Sallagrazhdë kemi vështirësi,është rruga e ngushtë dhe kanë ndodh disa aksidente.Do të ishte mirë të bëhet një pengesë për ndalimin e shpejtësisë - vendi te hyrja e Kishës.

Nënkyetarja - do ta marrim parasysh këtë kërkesë. Sa i përket ndriçimit, Komuna e ka një projekt të tillë në të ardhmen,ndërsa sa i përket sinjalizimit është punuar mjaft por kemi pas ngecje dhe nuk ka shku shpejt.

Rekomandim: Rritja e aktivitetit policor si dhe sinjalizimet kryesisht në vendkalimet për këmbësor.

Astrit Vrella - përshëndet të pranishmit. Desha ta pyes komandantin lidhur me dhënien e gjobave.Brenda oborrit të QKMF-së policia jep gjoba,ndërsa te gjimnazi ku janë veturat në mënyrë të çrregullt për shkak të vaksinimit nuk denohen. Sa është e drejtë kjo?

Afrim Sylaj - jep përgjigje.

Astrit Vrella - unë kam qenë me Kovid dhe polici zyrtar as që ka dasht me diskutu,dhe unë nuk pajtohem me këtë.

Afrim Sylaj - qytetarët vinë në treg për nevoja personale dhe veturat i lanë aty. Mirëpo policia nuk ka mujt me i identifiku të gjithë sepse ka qenë rrëmujë. Nëse është bo shkelje,ne e rregullojmë,është komisioni.

Astrit Vrella - vetura ime nuk e ka blloku trafikun. Me komunikua me drejtorinë e shëndetësisë për me vendos një roje për me i drejtu veturat.

Nënkryetarja- ndoshta Astriti ka të drejtë,por edhe drejtoresha ka bo kërkesë që të gjithë punëtorët e QKMF-së ti parkojnë veturat jasht oborrit sepse parkingu është 100 m afër të cilën e ka bo Komuna. Do të mundohemi me bo një zgjidhje.

Afrim Sylaj - do të bisedoj me drejtoreshën ,që ta bëjmë një zgjidhje sa ma të mirë.

Nënkryetarja - a pajtoheni me rekomandimet që u thanë.

Aprovohet

Pika 3. Raportimi dhe masat për parandalimin e dhunës në familje ;

Nënkryetarja - ne si Komunë kemi marrë masa për parandalimin e dhunës në familje,kemi zyrtaren për barazi gjinore,pastaj kemi kriju mekanizmin kundër dhunës në familje,ku vazhdimisht mbajmë takime. Rekomandimet që dalin nga ato takime,ne si Komunë jemi mundu të bëjmë përmirësim sa i përket parandalimit të dhunës në familje.

Habibe Bytyqi - Sa i përket raportimit gjendja është shumë shqetësuese në këtë 9 muor krahasuar me vitin 2020. Sa i përket dhunës në familje janë institucionet tona që e kanë detyrë me e trajtu çështjen e dhunës,dhe nga këto institucione ne mbledhim statistika. Sipas policisë në këtë nëntë muor kemi 60 raste krahasuar me vitin e kaluar që kanë qenë 37 raste ,ndërsa rastet që janë paraqitë në QPS janë 28 krahasuar me vitin e kaluar me 17 raste, dhe sa i përket QKMF kemi 34 raste krahasuar me vitin 2020 që kanë qenë 29 raste.Pra në bazë të statistikave kemi një ngritje dhe për ne është shumë shqetësuese. Mendoj që faktori kyç është besimi që qytetarët kanë ndaj institucionit për ta paraqit dhunën. - Sa i përket parandalimit të dhunës,i ceki edhe nënkryetarja,por dua të shtoj edhe një, që atë e bënë agjensioni për barazi gjinore. Janë disa spote vetëdijësuese që janë evitu nëpër televizione nacionale. Përshkak të Kovidit na ka mungu aktiviteti në teren dhe ne jemi tu u mundu me plotësu përmes spoteve.

Nënkryetarja - ne si mekanizëm funksionojmë mirë. Komuna që nga viti 2020 ka nda buxhet prej 2200 euro për strehimoren në Prizren,pastaj kemi bonos banimin për gra.Nga takimi i fundit është parapa që të formohet një fond emergjent,ku kemi nda një fond prej 1000 eurove në rast të nevojave të dhunës në familje.

Afrim Sylaj - sa i përket dhunës është shumë shqetësuese. Unë këtë numër e konsideroj si më të madhë sepse shumica nuk denoncojnë nga frika. Stacioni policor në Suharekë dhe të gjitha stacionet i kanë hetuesit e dhunës primare të cilët janë të trajnuar dhe merren enkas me çështjen e dhunës në familje. Ne vazhdimisht kemi kampanja senzibilizuese . Kemi arrestu 34 persona për dhunë në familje. Pjesa dërmuese janë femra ,dhe viktimat meshkuj kanë qenë tre raste.Rastet ma shumë janë të theksuara nëpër fshatra. Të mitur kanë qenë 9 viktimat,dhe të dyshuar fëmijë kanë qenë dy raste. Ne do të punojmë maksimalisht dhe shpresoj që numri i rasteve të bie.

Mikel Sopi - është problem i përgjithshëm dhe duhet të shikohet dhe të punohet më shumë për parandalimin se sa për shërimin e pasojave. E çmoj punën e zyrtarëve për barazi gjinore,dhe mendoj që të bëni mbështetjen e OJQ-ve për parandalimn e këtyre gjanave.

Nënkryetarja - nuk ka një ligj për mbështetjen e OJQ-ve por iu ndihmojmë me subvencione.

Astrit Vrella - këta dhunues,cilës kategori i përkasin ma shumë? A janë kushtet ekonomike,narkoman apo njerëz të alkoolizuar?

Astrit Bytyqi - këtë desha ta diskutoj edhe unë. Prej cilëve persona po na vjen kjo dhunë?

Habibe Bytyqi - po flas nga takimi i fundit dhe mbas diskutimeve secili institucion sikur e kanë dhënë një opinion të përgjithshëm,që problematika më e madhe ekziston te rastet e personave me shëndet mendor jo të duhur dhe te rastet,sidomos te lëndët narkotike. Dhe e keqja është që nuk kemi institucione që merren me rehabilitimin e këtyre personave.

Afrim Sylaj - rastet janë të llojllojshme por pjesa dërmuese e rasteve është bashkëshorti ndaj gruas.

Nënkryetarja- edhe pandemia ka shkaktuar raste. Psh mbyllja, gjendja e keqe ekonomike.

Halim Shehu - përshëndet të pranishmit. Në aspektin fetar, ne kemi mbajt ligjëratë për parandalimin kundër dhunës në familje këto gjëra duhet të njoftohen te institucionet përkatëse në mënyrë që të marrim masa dhe të zvogëlohen rastet.

Nazim Shabanaj - a mjaftojnë këto 100 euro që Komuna i ka nda për këto raste?

Nënkryetarja - është vlerë e vogël,por këto janë për ushqim ditor dhe për nevoja momentale.

Mikel Sopi - a keni provu që ta keni një donacion për këtë çështje?

Habibe Bytyqi - sa i përket OJQ-ve në Komunë që merren me dhunën në familje në përgjithësi janë pak.Për ato që i kemi mund të shkojmë përmes subvencionimit. Për këtë desha me dal me rekomandim, që të shiqohet rritja e mundësisë për financim të OJQ-ve të cilat merren me fushata vetëdijësuese.

Mikel Sopi - është temë e ndjeshme dhe mendoj që ka mjaft faktor ndërkombëtar që do tregonin interesim për mbështetjen e punës suaj.

Rekomandim: Rritja e aktiviteteve sensibilizuese për parandalimin e dhunës.

Rritja e mundësisë së financimit të OJQ-ve.

Aprovohen Rekomandimet

Pika4. Informatë nga drejtorja e shërbimeve publike,mjedis dhe emergjencë lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin veror dhe përgatitja për sezonin e dimrit;

Nënkryetarja - i njofton të pranishmit se Komuna ka marrëveshje financimi dhe bashkëfinancimi në mes kompanisë regjionale “Eko regjionit”.Nënkryetarja lexon marrëveshjen.

Afrim Sylaj - në aspektin veror është mirë të pastrohen më shumë trotuaret. Dhe si rekomandim të del që të rritet pastërtia dhe më tutje edhe nëpër fshatra dhe zona rurale dhe të ekzistojë një kompani kontraktuese për pastrimin e trotuareve.

Astrit Bytyqi - nga kompania duhet të kërkohet që të ketë më shumë kontinier të mbeturinave. Kam has në një pushimore ku bërlloku është shpërnda. Në fshatin Leshan kemi mirëmbajtje,ku na paguan mërgata,mirëpo pjesa te Topliqani hudhin mbeturina.

Mikel Sopi - Kemi një festë me 1 nëntor ku i përkujtojmë të vdekurit dhe kemi nevojë për një kontinier branda javës në fshatin Sallagrazhdë,ku rruga ndan varrezat. Do të ishte një zgjidhje e mirë.

Shkëndije Shabanaj - përshëndet të pranishmit. Në fshatin Gelancë në një pjesë janë vendos shportat për mbeturina por pjesa tjetër e fshatit është pa shporta. Është shqetësuese për ne që të hedhen mbeturinat,ndoshta edhe me traktor në lume. Është pastru disa herë lumi por prapë ka vazhduar.

Nënkryetarja - vitin e kaluar kemi pas donacion shumë kontinier,të cilat janë shpërnda në shumë fshatra.

Rekomandim: Identifikimi i zonave ku duhet të vendosen kontinir.

Të vazhdohet me mirëmbajtje të trotuareve dhe rrugëve.

Astrit Bytyqi - a kanë leje shitësit te autostrada?

Nënkryetarja - ata nuk kanë leje nga Komuna dhe Komuna kanë tentu mi largu.

Aprovohen Rekomandimet

Takimi përfundoi: 11 : 30

Procesmbajtësja:

Dafina Haziraj